



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 30 maj 2013

**Prezantimi i Analizës së Situatës –
pjesë e projektit të financuar nga EIDHR: “Përfshirja e
romëve - grumbullues joformalë të mbeturinave – në skemat
formale”**

Qendra Informative e BE-së

Fjalim

Ambasadori Aivo Orav

Shef i Delegacionit të BE-së

I nderuari Zëvendës Ministër, z. Ibrahim,
Zonja dhe zotërinj,

Prezantimi i sotëm i konkluzave fillestare të Analizës së Situatës për përfshirjen e romëve-grumbullues joformalë të mbeturinave – në skemat formale të mbeturinave, me shpresë do të mundësojë standarde më të mira jetese për romët.

Analizën e realizoi projekti i financuar nga EIDHR - Përfshirja e romëve - grumbullues joformalë të mbeturinave – në skemat formale. Projekti ka për qëllim t'u ndihmojë grumbulluesve joformalë të mbeturinave të bëhen pjesë e menaxhimit formal të mbeturinave në nivel lokal, duke zhvilluar një model nga komunat, ndërmarrjet private dhe publike të shërbimeve komunale, përfaqësues të agjencive të punësimit, Shoqata e Grumbulluesve Joformalë të Mbeturinave, ndërmarrjet private të riciklimit dhe shoqëria civile.

Mbrojtja e mjedisit dhe të drejtave sociale janë në krye të agjendës së BE-së. Këto janë gjithashtu prioritete të të gjitha vendeve që aspirojnë të bëhen anëtare të Bashkimit Evropian.

Industria e riciklimit dhe implementimi i Ligjit mbi menaxhimin e paketimit të mbeturinave, mund të krijojë standarde më të mira jetese për rreth 5000 persona dhe familjet e tyre.

Gjatë këtij projekti, qyteti i Shkupit, komunat e Koçanit dhe Strumicës, do të përkrahen në hartimin e planeve të veprimit lidhur me identifikimin e zgjidhjeve për riciklim të qëndrueshëm dhe për sigurimin e standardit të qëndrueshëm jetësor për romët - grumbullues joformalë të mbeturinave.

Bashkëpunimi me komunat është vendimtar, pasi që puna e përbashkët do të shtojë vetëdijen publike për grumbulluesit joformalë të mbeturinave, riciklimin dhe do të ofrojë kushtet për programet e riciklimit të vazhdueshëm në vend.

Integrimi i grumbulluesve joformalë të mbeturinave në sistemin formal të grumbullimit të mbeturinave do të arrije një qëllim të dyfishtë: 1) do të shtohet punësimi i grupeve të marginalizuara dhe 2) do të sigurohet mjedis i pastër jetësor për qytetarët.

Ju dëshiroj sukses në arritjen e këtyre qëllimeve!

Ju falemnderit për vëmendjen.